



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:098090

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06592887

C.nr.3006/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Liridona Haziri-Mustafa, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve XH.B, S.Q, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Vlora Kadriu, avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi i rritjes së pensionit të moshës sipas indeksit të koston së jetesës dhe inflacioni, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore, me datën 22.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, shpallet **JO KOMPETENTE** në pikëpamje lëndore dhe **HEDHET POSHTË E PALEJUAR** padia e paditësve XH.B, S.Q, me shenjen C.nr.3006/24, e datës 28.03.2024, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, në çështjen juridike kompensimi i rritjes së pensionit të moshës sipas indeksit të koston së jetesës dhe inflacioni.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuares së tyre, më datë 28.03.2024, kanë paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, për kompensimin e rritjes së pensionit të moshës sipas indeksit të koston së jetesës dhe inflacionin.

Kjo gjykatë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, gjeti se çështja e cila është objekt i kontestit nuk përbën çështje gjyqësore, por e njëjta përfaqëson çështje administrative sipas Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore.

Sipas Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, me nenin 13 është përcaktuar që paraparë që “Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë

së Financave, me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj”, ndërsa me nenin 14, par. 4 pika e të njëjtit ligj, Ministria e Financave në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.2002/1 mbi Metodologjinë e Caktimit të Lartësisë së Pensionit Bazë në Kosovë, do të jetë përgjegjëse për llogaritjet që kërkohen nga ky ligj dhe për përcaktimin e nivelit të rritjes së pagesave të pensioneve të përcaktuara me këtë ligj. Tutje, neni 18 par. 1 i të njëjtit ligj përcakton që departamenti përkatës për pensione i Ministrisë, është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj. Kurse me nenin 19, par. 1 të këtij Ligji përcaktohet se “Të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimit të kërkesës në Ministri.”

Në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, kjo gjykatë vlerëson çështja e pensioneve është kompetencë e organeve administrative, përkatësisht e Departamentit përkatës për Pensione i cili funksionon në kuadër të Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Së këndejmi, kërkesa e paditësit për mbrojtje gjyqësore sipas padisë nuk mund të realizohet në procedurë kontestimore, dhe as në procedurë të konfliktit administrativ, për faktin se lidhur me kontestin e natyrës së tillë, gjykatës i mungon kompetenca gjyqësore për vendosje për çështjen e ngritur me padë.

Në këtë mënyrë, gjykata vlerëson se janë plotësuar prezumimet procedurale që të veprohet në kuptim të dispozitës së nenit 18, par.2 të LPK-së, e cila përcakton që “Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t’i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur”. Lidhur me këtë, dispozita e nenit 391, pika a) përcakton: “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padë nuk hynë në kompetencën gjyqësore”.

Nga të cekurat në kuptim të dispozitës së nenit 17, 18.1, 18.2, 19 dhe 391 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendim.

GJYKATA THMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.3006/24, datë 22.11.2024

Gjyqtarja,
Liridona Haziri-Mustafa

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.